



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1691 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2023

VENDIM
Nr. 458, datë 24.08.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2023:

VENDOSI:

- Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Ndërtimi i linjës së re 220 kv Dopjo Qark Fier- Hoxharë me përcjellës ACSR 490/65, si dhe ndërtimi i Nënstacionit të ri 220/11020 KV Hoxharë, bashkë me dy dalje linje 220 KV”, me nr. pasurie 700, Zona Kadastrale 3358, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, me aplikues dhe zhvillues “OST” sh.a;
- Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
- Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Ndërtimi i linjës së re 220 kv Dopjo Qark Fier- Hoxharë me përcjellës ACSR 490/65, si dhe ndërtimi i Nënstacionit të ri 220/11020 KV Hoxharë, bashkë me dy dalje linje 220 KV” si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 145 - 147;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Klesta QIRICI

Klesta
Qirici

Digitally signed by
Klesta Qirici
Date: 2023.08.25
13:31:57 +02'00'

Elva
Margariti

Digitally signed by Elva
Margariti
Date: 2023.08.25
13:40:14 +02'00'